



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900182/5

Tiranë ____/____/2019

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e fëmijës me inicialet P.M, në çerdhen nr.57 "Pinoku", Tiranë.

BASHKISË TIRANË

QENDRËS EKONOMIKE TË ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË

FËMIJËVE

NJËSISË ADMINISTRATIVE NR.5

NJËSISË PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të pikës 1, të nenit 60, të Kushtetutës si dhe, ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën e shtetases Brikena Mejdani, banuese në Tiranë. Ajo është anëtare e komunitetit rom, e papunë dhe ka tre fëmijë.

Kjo ankesë adreson problematikën e hasur në qershor 2018, kur zj.Mejdani ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për të regjistruar vajzën 1 vjeç e gjysëm (P.M), në çerdhen "Pinoku", të Njesisë Administrative nr.5, Tiranë.

Pas pranimit të dokumenteve, vajzën e regjistruan në sistem, por në datën 2 shtator 2018, në ditën e parë të fillimit të çerdhes, nga drejtoresha e çerdhes “Pinoku” iu komunikua, që nuk ka vend për fëmijën.

Në shkresën zyrtare, nr. K5/B1-2 prot., datë 8.2.2019, institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi informacion, lidhur me objektin e kësaj ankese.

Referuar shkresës me nr.543/1 prot., datë 18.2.2019, Njësia Administrative nr.5 Tiranë, na informoi se kjo familje ka aplikuar për të përfituar ndihmën ekonomike, por nuk e ka fituar atë. Pasi e kanë kontaktuar, në muajin qershor 2018, ka dorëzuar dokumentacionin pranë çerdhes Pinoku, për t’a regjistruar vajzën e saj. Ka rezultuar se në muajin shtator 2018, ky institucion nuk kishte vend. Drejtoresha e këtij institucioni e ka sqaruar, se procesin e përzgjedhjes së fëmijëve për në çerdhe e kryen Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Tiranë.

Po ashtu, kjo njësi administrative e orientoi ankuesen për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Ndërsa, referuar shkresës nr.182/1 prot., më datë 20.2.2019, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Tiranë, na informon se:

-Zj.Brikena Mejdani ka aplikuar pranë çerdhes për të regjistruar fëmijën e saj, duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, si dhe formularin e aplikimit, ku të dy prindërit rezultojnë të papunë dhe nuk trajtohen as me ndihmë ekonomike.

-Ky institucion (QEZHEF) i ka dhënë prioritet fëmijëve që vijnë, nga familjet me probleme social-ekonomike, referuar vendimit përkatës të këshillit bashkiak të Tiranës¹, më pas prindërve që janë aktualisht në marrëdhënie pune, sepse ka një raport të lartë midis kërkesave dhe kapaciteteve.

Po ashtu, sqarohet se nuk janë konsideruar si prioritarë për regjistrimin e fëmijës në çerdhe, për arsye se të dy prindërit e fëmijës nuk janë në marrëdhënie pune, si dhe për mungesë dokumentacioni për t’u klasifikuar si familje me probleme social-ekonomike.

¹ *Vendimi nr.40, datë 29.3.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak, me nr.59, datë 30.12.2015, për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”.*

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm me Ju, e konsideron mjaft të rëndësishëm, që në çdo veprim apo vendim që mund të merret nga kushdo, të përmbushet apo të plotësohet interesi më i lartë i fëmijës. Ndaj në këtë kontekst, e konsiderojmë të papranueshëm mosregjistrimin e kësaj fëmije, të ditëlindjes 2017, në një çerdhe publike.

Fakti, që kjo familje e komunitetit Rom, as nuk është e regjistruar në sistemin e ndihmës ekonomike, dhe që të dy prindërit janë të papunë, e bën edhe më urgjente nevojën e ndërhyrjes në këtë rast.

Çerdhja është një qendër shërbimi edukative dhe shoqërore, e hapur për të gjithë fëmijët dhe mundëson, së bashku me familjen, rritjen e tyre dhe edukimin. Çerdhja është një mjedis i një jete me ndërlidhje të shumta, ndërmjet fëmijëve të grupit, bazuar në respektin reciprok, në kujdesin për fëmijët dhe mirëqenien e përditëshme.

Nuk duhet harruar, se hyrja në çerdhe dhe kopshte është përvoja e parë e jetës kolektive për fëmijët, pasi ndërveprimi social përbën rrënjët e zhvillimit të shëndetshëm dhe, një ndër kushtet më të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të tyre. Çdo moment i jetës në çerdhe ka një domethënie të rëndësishme për fëmijët dhe organizimi i përditshëm i shërbimit duhet përqëndruar në sigurimin e mirëqenies dhe të pavarësisë së tyre.

Për fëmijën, në veçanti, do të thotë të hyjë e të bëjë pjesë në një mjedis të ri dhe të jetojë e ndërveprojë duke njohur, jo vetëm mjaft fëmijë të tjerë, por edhe të rritur, të ndryshëm nga familjarët e tij, dhe, që shoqërohet me ndryshime pozitive, si për fëmijën, ashtu edhe për familjen e tij.

Me qëllimin dhe dëshirën e mirë, që situata të tilla të mos përsëriten dhe, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijës, i cili nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe në respektim të legjislacionit në fuqi, institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar,

R E K O M A N D O N:

-Marrjen e masave për regjistrimin e fëmijës me inicialet P.M, në çerdhen nr.57“Pinoku”, Tiranë.

-Marrjen e masave për ndërgjegjësimin dhe trajnimin e stafit të Qendrës Ekonomike të Edukimit të Fëmijëve dhe personelit të kopshteve, për

mbrojtjen e drejtave të fëmijëve dhe shmangien e çdo forme të mundshme diskriminimi ndaj fëmijëve të komunitetit Rom.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditë nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R I

Nejla PEKA